

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2024

Lënda: GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim dhe arsyetim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19	20	21	22	23	24
Pikët								
Kërkesa	25	26	27	28	29	30	31	32
Pikët								
Kërkesa	33a	33b	33c	33d				
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

Shpirti kritik

N' art e ndër letra, në shkencë, në filosofi, e deri në fë, kritika asht baza e çdo ndërtimi të sigurtë.

Kritika asht shëji i mendjes së pjekun.

Derisa mendja nuk kthehet me rishikue atë çka ka bâ, tue e vlerësue, ajo asht ende fëminore. Ajo mund të prodhojë vepra madhështore, kur intuita e përpjek me burimin e jetës. Kështu lindë poezija. E sigurisht poezija e madhe flet vetë, tue u-kumtue imtaz ndër zemrat e atyne që e ndijnë; spjegon arsyen e qenjes së vet me vetë qenjen e vet.

Po atherë çka duhet kritika?

Të marrim një njeri që ndërton. Ky njeri mund të jetë artist i lindun e atherë vepra e tij del vetvetiu e bukur. Po të mos jetë mjeshtër i fortë, pa qenë edhe krejt pa zotsí, do të ndërtojë dikund mirë e dikund keq. Fjala vjen në përgjithsi vepra do të jetë mjaft e bukur, por ndër veçansina e pakryeme. Por mund të ndodhi që një njeri krejt i paaftë të ja hyjë "kutrum" një pune. Ç'dobi pritët andej kuptohet lehtë: veç punë e bjerrun e dam.

Kritiku asht njeriu që ndalet me shikue kët vepër. Dhe simbas rasës, aj çfaqë gjykimet e veta. Në rasën e parë, aj kundron me bindje fuqin e mjeshtër: fjalët e tija janë lavde, por lavde t'arsyetueme në bazë të meritavet të veprës. Kritiku i përshkruen kto, i ven në pah, difton harmonin e motivavet të thurun, lidhjen e mshehtë që rjedh ndër ta, përshtatjen e elementavet me tansin. Me një fjalë spjegon misterin e veprës. Pse vepra shpesh herë nuk asht aq e lehtë të spjegohet. Para një vjershe a një kuadri gjenial të gjithë thrrasim: "sa bukur!", por vetëm ndonji din me tregue pse asht e bukur. Një ah! Del përnjiheri nga shpirti i ngashëryem. Por arsyeja e ktij ah! lypë arsyetime shpesh të thella e të gjata.

Në rasën e dytë detyra e kritikut asht me dallue të mirat e të këqijat e veprës, ose për me ja thanë popullorçe: "me dá shapin prej sheqerit". Kjo asht gjithashtu një punë e vështirë. Janë disa cilsina që duhen pasë doemos për me bâ dallimin e masipërm. Kush ka pamje të dobtë, fjala vjen, ngatrron vazhdimisht të bardhën e shapit me të bardhën e sheqerit. Në rasën e parë duhej me pasë sidomos fund, themel, për me u-mbështetë me siguri; hapësinë, horizont për me përfshi gjithë veprën; masë për kqyrë drejtë e saktë. Tash duhet me pasë sidomos *shije*. Shija asht ajo që dallon pikërisht shapin prej sheqerit. Dhe shija asht një pajë e veçantë. Ka soje soje shijesh: ajo e holla, e sakta ndeshet shumë rrallë.

Për me gjykue veprat e dështueme, nuk asht fort nevoja për me pasë cilsí të veçanta. Gjanavet të kalbta u ndihet era qysh larg, mjafton me pasë hundë të qërueme. Zakonisht ato rrëzohen vetiu, pa nevojë ndërhyrje kirurgjike. Por ndodhë ndonjiherë që ngjiten me mishin e shëndoshtë. E atherë asht nevoja me i dliërë. Edhe kjo farë kritike nuk asht e lehtë si kujtohet. Do e kush do nuk mund ta bajë: njëni kalon e mbyllë hundët, tjetri kalon e mbyllë gojën. Kush do të gjindet edhe për kët punë të pamiradishme? Për kritikën themelore duhej pesha e *mendjes*, *kultura*. Për kritikën e shijes, *prehtësija* e *mendjes* a *squetsija*.

Kritika nuk asht pra një punë e lehtë, e aq ma pak, kotë. Ajo bjen në prodhimin letrar rend e dallim, masë e qartësi, kuptim e vlerë. Vrejtyet e saja janë kshilla e qortime e ndonjiherë edhe shtytje e udhëzime. Ajo përcakton zonat e ndryshme të zhvillimit letrar. I ep shkrimtarit rendin që i perket. Me krahasime e përgjamje afron shkrimtarët që kan lidhje mes tyne. Kërkon, përsa asht e mundun, me gjetë fillin historik që lidhë, si ndër unaza të vijueshme, shkrimtarët ndër familje të veçanta, e kto familje në një tabelë logjike të plotsueme. Dhe ma në fund lidhë historin letrare me historin e kulturës së përgjithshme tue i dhanë letërsís dinjitetin e vet njerzuer.

Arshi Pipa, (Shkodër, 28 korrik 1920 - Uashington, 20 korrik 1997) publicist, poet, gjuhëtar, kritik letrar, përkthyes.

berrun – (këtu) çuar

kutrum – (këtu) kuturu

përgjamje – (këtu) ka të ngjarë

shapi – kripë minerale

tansinë – tërësi

-
1. Në cilat rrethana, sipas autorit, mund të flasim për një *punë të çuar dëm*, nga ana e shkrimtarit? **1 pikë**
- A) Kur një i paaftë për të ndërtuar një vepër artistike, nis të ushtrojë profesionin e artistit.
B) Nëse një artist i lindur nuk merr parasysh orientimin e kritikës gjatë punës së tij.
C) Në qoftë se artistët krijojnë artin e tyre vetëm për lexuesit e elitës intelektuale.
D) Atëherë kur poetët nuk kuptohen nga masat e lexuesve.
2. Kuptimi i fjalisë: "*Kritika asht shëji i mendjes së pjekun.*", është: **1 pikë**
- A) Kritika është tregues i ekzistencës së studiuesve të shenjtë.
B) Kritika është e shenjtë se buron nga një mendje e pjekur.
C) Kritika është shenjë e mendjes së urtë e të matur.
D) Kritika është shenjtërim i mendjes së zhvilluar.
3. Në cilën prej alternativave shprehet teza sipas gjykimit të autorit të këtij teksti? **1 pikë**
- A) Kritika dëmton iniciativat e krijuesve që nuk kanë talent të jashtëzakonshëm.
B) Kritika udhëzon autorët se si të shkruajnë për t'u bërë shkrimtarë të mëdhenj.
C) Kritika zbulon vlerat e veprës letrare dhe i jep letërsisë dinjitetin e vet njerëzor.
D) Kritika mbështet vetëm krijimet artistike që u përkasin rrymave moderne në letërsi.
4. Ç'funksion luan në tekst fjalia pyetëse: *Po atherë çka duhet kritika?* **1 pikë**
- A) I hap rrugën artificialisht argumentimit të tezës.
B) Ndhmon përshkrimin me mjetet shprehëse sintaksore.
C) Siguron distancën e plotë të komunikimit mes autorit e lexuesit.
D) Tërheq vëmendjen e lexuesit për ta bërë pjesë në komunikim.
5. Cili është referenti i këtij teksti? **1 pikë**
- A) Kritika
B) Letërsia
C) Ndërtuesi
D) Shkrimtari
6. Ç'loj argumentesh janë përdorur në tekst? **1 pikë**
- A) Argumente të mbështetura në të dhëna statistikore.
B) Argumente të fushës përkatëse.
C) Argumente shkencore.
D) Argumente logjike.
7. Cila prej fjalive të shkëputura nga teksti është fjali e thjeshtë? **1 pikë**
- A) N' art e ndër letra, në shkencë, në filosofi, e deri në fé, kritika asht baza e çdo ndërtimi të sigurte.
B) Marrim nji njeri që ndërton.
C) Derisa mendja nuk kthehet me rishikue atë çka ka bâ, tue e vlerësue, ajo asht ende fëminore.
D) Janë disa cilsina që duhen pasë doemos për me bâ dallimin e masipërm.

8. Pjesa e nënvizuar në fjalinë: " Të marrim një njeri që ndërton", është: **1 pikë**

- A) pjesëz.
- B) lidhëz.
- C) parafjalë.
- D) përemër lidhor.

9. Pjesa e nënvizuar në fjalinë: " Por mund të ndodhi që një njeri krejt i paaftë të ja hyjë "kutrum" një pune.", është: **1 pikë**

- A) e prejardhur.
- B) e parme.
- C) e përbërë.
- D) e përngjitur.

10. Koha e foljeve që mbizotëron në fragment është: **1 pikë**

- A) koha e pakryer.
- B) koha e ardhme.
- C) koha e tashme.
- D) koha e kryer.

11. Në fjalinë: "Në rasën e parë, aj kundron me bindje fuqin e mjeshtrit: fjalët e tija janë lavde, por lavde t'arsyetueme në bazë të meritave të veprës". Zëvendësoni fjalët e nënvizuara me një fjalë të vetme, duke ruajtur kuptimin e fjalisë. **1 pikë**

12. Përveç përdorimit të fjalisë pyetëse, autori ka përdorur edhe teknika të tjera të gjuhës bashkëbiseduese.
a) Identifikoni njërin prej tyre, që sipas mendimit tuaj, siguron një audiencë më të gjerë. **1 pikë**

b) Ilustroni përgjigjen tuaj me një shembull nga teksti. **1 pikë**

13. Për të mbështetur argumentin e tij në raport me tezën, autori shfrytëzon një shembull jashtëletrar. A e realizon ai qëllimin përmes tij? Argumentoni mendimin tuaj duke ilustruar me shembullin e tekstit. **3 pikë**

Argumenti:

Shembulli:

14. Autori në tekstin e mësipërm shprehet: "Për **kritikën themelore** duhej pesha e mendjes, kultura. Për **kritikën e shijes**, prehtësia e mendjes a squetsija."

Analizoni këto lloje të kritikës. Cili është ndryshimi mes tyre?

3 pikë

15. Kur autori shprehet: "Ka soje soje shijesh: ajo e **holla e sakta** ndeshet shumë rrallë", ai nënkupton se jo çdokush mund të jetë kritik i një veprë letrare. Sipas mendimit tuaj, cilat janë dy nga karakteristikat që duhet të zotërojë një kritik letrar, në mënyrë që të ketë shije **të hollë e të saktë**? Argumentoni arsyet e zgjedhjes suaj.

3 pikë

16. Rrethoni alternativën e saktë sipas gjuhës standarde, për fjalët e nënvizuara të shkruara në dialekt. 4 pikë

Kritiku asht njeriu që ndalet me shikue këtë vepër. Dhe simbas rasës, aj çfaqë (1) gjykimet e veta. Në rasën e parë, aj kundron me bindje fuqin e mjeshtrit: fjalët e tija janë lavde, por lavde t'arsyetueme në bazë të meritavet të veprës. Kritiku i përshkruen kto, i ven në pah, difton harmonin e motivavet të thurun, lidhjen e mshehtë (2) që rjedh ndër ta, përshtatjen e elementavet me tansin. Me një fjalë shpiegon (3) misterin e veprës. Pse vepra shpesh herë nuk asht aq e lehtë të spjegohet. Para një vjershe a një kuadri gjenial të gjithë thrrasim: "sa bukur!", por vetëm ndonji din me tregue pse asht e bukur. Një ah! Del përnjiheri (4) nga shpirti i ngashëryem. Por arsyeja e këtij ahu! Iypë arsyetime shpesh të thella e të gjata.

- | | | | |
|------------------|--------------|---------------|--------------|
| 1. A) çfaqë | B) shfaqë | C) shfaq | D) çfaq |
| 2. A) mshehtë | B) fshehtë | C) fshetë | D) mshetë |
| 3. A) spjegon | B) shpiegon | C) spiegon | D) shpiegon |
| 4. A) përnjiheri | B) përnjëher | C) përnjëherë | D) përnjiher |

Viktor Hygo

Katedralja e Parisit

Ciganes iu bë një pritje jashtëzakonisht e ftohtë. Zonjushat e këqyrën nga koka te këmbët, pastaj u panë sy në sy dhe kjo qe e mjaftueshme: ato e kishin kuptuar njëra-tjetrën. Ndërkaq vajza e re po priste t'i flisnin dhe ishte aq e turbulluar, saqë nuk guxonte të ngrinte qepallat.

Kapiteni e theu heshtjen i pari.

- Për fjalë të nderit, - tha ai me tonin e tij mendjemadh dhe disi të paturpshëm, - ja një krijesë magjepsëse!
Ç'thoni ju, e bukur kushërirë?

Kjo vërejtje, të cilën një adhurues me ndjenja pak më të holla do ta kishte bërë me gjysmë zëri, nuk mund ta zhdukte natyrisht, xhelozinë femërore, që kishte ngritur krye pas ardhjes së ciganes.

Flër-de-Lisi iu përgjigj kapitenit si me mospërfillje:

- S'është e keqe!

Të tjerat po pëshpëritnin me shoqja-shoqen.

Më në fund, zonja Aloizë, që ishte shqetësuar po aq sa të tjerat, jo për vete po për të bijën, tha:

- Afrohu këtu, vogëlushe.
- Afrohu këtu, vogëlushe! – përsëriti me një dinjitet komik Beranzhera, që mezi i arrinte ciganes deri te beli.

Cigania u afrua te ajo zonjë aristokrate.

- Çupëlinë e lezetshme, - tha kapiteni rëndë-rëndë, duke bërë disa hapa drejt saj, - nuk e di nëse e meritoj lumturinë e lartë të më njihni...

Vajza ia ndërpreu fjalën duke i buzëqeshur atij dhe duke i hedhur një vështrim plot ëmbëlsi.

- Oh, po! – u përgjigj ajo.
- Paska kujtesë të mirë, - vërejt i Flër-de-Lisi.
- Po sa shpejt krisët e ikët atë natë! – vijoi Febysi. – Mos ndoshta patët frikë prej meje?
- Oh, jo! – u përgjigj cigania.

Mënyra se si u shqiptua kjo "oh, jo!", pas asaj "oh, po!"-je, kishte në vetvete njëfarë theksimi të veçantë, që e lëndoi Flër-de-Lisin.

- Ju ikët o bukuroshe dhe në vendin tuaj latë një lolo fytyrëngryset, gungaç dhe qorr me një sy, që më duket se ishte kambanari i peshkopit, - vazhdoi të thoshte kapiteni, të cilit iu zgjidh gjuha menjëherë tani që po fliste me një vajzë sido-kudo. – më thanë se ai qenka i prapë si djalli vetë. Paska një emër për të qeshur, u quajtka "E premtja e zezë", "E diela e Palmave", as mua s'më kujtohet; shkurt, ka emrin e një feste fetare! Dhe ai pati guximin t'ju rrëmbente, thua se jeni krijuar për dhjakët! E bukur kjo! E çfarë dreqin donte prej jush ai hut? Eh, pa më thoni?
 - As unë s'e di – u përgjigj ajo.
 - Ç'paturpësi! Një kambanar të rrëmbejë një vajzë, si të ishte ndonjë viskont. Një harbut të ndjekë prenë e aristokratëve! Ku është parë e dëgjuar kjo! Sidoqoftë, ai e pagoi shtrenjtë këtë. Metr Piera Tortëryi është ustai më i mirë që ua rrjep lëkurën horrave, dhe unë mund t'ju them, në qoftë se keni qejf ta dëgjoni, se ai ia bëri copë kurrizin kambanarit tuaj.
 - I shkreti! – tha cigania, së cilës këto fjalë i kujtuan skenën që kishte parë te shtylla e turpit.
 - Kapiteni ia plasi gazit.
-

-
17. *Katedralja e Parisit* është roman: 1 pikë
- A) psikologjik.
B) shoqëror.
C) filozofik.
D) historik.
18. Linjën kryesore të subjektit të veprës e përbën: 1 pikë
- A) lufta për të shpëtuar popullin.
B) lufta për të shpëtuar katedralen.
C) lufta për të shpëtuar Esmeraldën.
D) lufta për të shpëtuar Kuazimodon.
19. Arkitektura e katedrales sipas përshkrimit të Hygoit është e stilit: 1 pikë
- A) gotik.
B) antik.
C) barok.
D) neoklasik.
20. Kuazimodo në këtë fragment prezantohet nga: 1 pikë
- A) fjalët e autorit.
B) fjalët e Febysit.
C) fjalët e Esmeraldës.
D) dialogu i personazheve.
21. Në hyrje të fragmentit autori pohon: "*Ato e kishin kuptuar njëra-tjetrën.*". Kjo nënkupton se zonjushat: 1 pikë
- A) u befasuan nga shkathtësia e ciganes.
B) u mrekulluan nga bukuria e Esmeraldës.
C) u shtangën nga shëmtia shpirtërore e kërcimtares.
D) u mirëkuptuan për shtresën shoqërore nga vinte vajza.
22. Në fjalinë: "*E çfarë dreqin donte prej jush ai hut?*", gjendet përdorimi i fjalës "*hut*". Cila nga alternativat e mëposhtme përmbush kuptimin e fjalisë, sipas fjalorit: 1 pikë
- A) *ndajf. krahin*. Shumë mirë, si s'ka më mirë. E kanë kaluar hut.
B) Zog huti. *fig. shar*. Njeri i trashë nga mendja; njeri i shushatur, matuf.
C) *zool.* një lloj bufi, me kokë të madhe e të rrumbullakët, me sqep të shkurtër e të kthyer.
D) *zool.* buf që rron nëpër pyje dhe këndon natën sikur vajton. Huti me veshë- buf me veshë. Kënga e hutit.
23. Cila nga replikat në tekst ironizon reagimin e Esmeraldës, pasi kapiteni i flet për herë të parë asaj? 1 pikë
- A) S'është e keqe!
B) Paska kujtesë të mirë.
C) Afrohu këtu, vogëlushe.
D) Mos ndoshta patët frikë prej meje?

-
24. Në cilën nga alternativat është përdorur shprehje frazeologjike? 1 pikë
- A) Ia plasi gazit.
B) E premtja e zezë.
C) Paska kujtesë të mirë.
D) Afrohu këtu, vogëlushe.
25. Cila është figura e sintaksës poetike që është përdorur në fjalinë: "Ju ikët o bukuroshe dhe në vendin tuaj latë një lolo fytyrëngrysët, gungaç dhe qorr me një sy, që më duket se ishte kambanari i peshkopit."? 1 pikë
- A) elipsë.
B) inversion.
C) shkallëzim.
D) enumeracion.
26. Gjendja shpirtërore e Esmeraldës në këtë fragment shfaqet: 1 pikë
- A) e trazuar.
B) e kënaqur.
C) e ekzaltuar.
D) e shqetësuar.
27. Lexoni me kujdes fjalët e Febysit. Zbuloni një moment ku vihet re qartë diferenca mes shtresave shoqërore. 1 pikë
- _____
- _____
28. Dalloni llojin e rrëfimitarit në tekst. Ç'të veçantë ka ky lloj rrëfimtari në raportet që krijohen mes autorit dhe personazheve në fragment? 3 pikë
- Lloji i rrëfimitarit:*
- _____
- _____
- E veçanta:*
- _____
- _____
29. Si reagon Esmeralda nga fillimi i fragmentit deri në fund? Ilustroni përgjigjen tuaj me dy detaje nga fragmenti. 3 pikë
- Reagimi i Esmeraldës:
- _____
- _____
- Ilustrimet:
- _____
- _____

30. Zbuloni tonin e rrëfimitarit në këtë fjali: *"Afrohu këtu, vogëlushe! – përsëriti me një dinjitet komik Beranzhera, që mezi i arrinte ciganes deri te belli."*. Cilat janë dy detajet që ju bëjnë të arrini në këtë konkluzion? **3 pikë**

Toni i rrëfimitarit: _____

Detajet: _____

31. Si zbulohet karakteri i Febysit përmes dialogut? Argumentoni mendimin tuaj përmes dy ilustrimeve nga teksti. **3 pikë**

Karakteri i Febysit: _____

Ilustrimet: _____

32. Fundi i fragmentit ndërtohet mbi bazën e një kontrasti. Zbulojeni atë, duke analizuar teknikat që shfrytëzon autori për të karakterizuar personazhet e tij. **3 pikë**

Kontrasti:

Teknikat:

Ese argumentuese

33. Lexoni situatën e mëposhtme:

Kur Era po lundronte në internet, ajo pa disa lajme rreth inteligjencës artificiale, përmes së cilës zëvendësohet puna njerëzore. Ajo ishte e dyzuar, prandaj i shkroi shoqes së saj më të mirë Anës, që jeton në Tokio, për t'i kërkuar mendim.

E-mail i ri
Marrësi: ana_2024@gmail.com
Tema: Inteligjenca artificiale

E dashur Ana!

Si je? Kam qenë shumë e ngarkuar këto kohë, prandaj nuk të kam shkruar. Të lutem më fal!
Gjithnjë e më tepër po shoh në internet lajme rreth inteligjencës artificiale, që zëvendëson punën njerëzore dhe doja t'i ndaja ato me ty.


Kështu, kompani që zhvillojnë makina vetëdrejtuese lejuan publikun të provonte taksitë vetëdrejtuese, për të zëvendësuar shoferët e taksive. Restorante të ndryshme kanë instaluar robotë të lëvizshëm për të mbledhur pjatat, si dhe makina porositëse vetëshërbimi. Robotët e pastrimit mund të pastrojnë një sipërfaqe prej 1200 metrash katrorë në orë, ChatGPT-ja po zëvendëson punën e publicistëve, gazetarëve, arkitektëve etj.

Mbarë bota po investon në zhvillimin e teknologjisë, përmirësimin e efikasitetit të punës dhe shijimit të rehatisë që sjell inteligjenca artificiale. Megjithatë, gjithnjë e më shumë, inteligjenca artificiale po shkakton panik tek njerëzit, nga frika se ata mund të humbasin punën e tyre.

Dua të di, çfarë mendon ti për inteligjencën artificiale?

Pres me padurim përgjigjen tënde.

Me dashuri Era.



Supozoni se jeni Ana. Përgjigjuni Erës, përmes një eseje, ku të argumentoni mendimin tuaj për inteligjencën artificiale.

E-mail i ri
Marrësi: era_2024@gmail.com
Tema: Inteligjenca artificiale

E dashur Era!

Me dashuri Ana.

Rich text editor toolbar with options: Undo, Redo, Sans Serif font, Text color, Bold, Italic, Underline, Text background color, Bulleted list, Numbered list, Indent, Outdent, Send button, and a trash icon.

Shtjellimi i idesë (33 a)	Organizimi dhe struktura (33 b)	Stili dhe origjinaliteti (33c)	Saktësia gjuhësore (33d)	Totali 33
2 pikë	2 pikë	2 pikë	2 pikë	8 pikë